**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 48, 49 dhe 50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 02/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Raporti mbi Arritjet dhe Sfidat në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit.

2. Raporti nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 03/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

# V E N D I M
## Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet Projektligji për Ratifikimin e plotësim - ndryshimit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2015 në mes Kosovës dhe BE-së, (MIE) – 22.07.2018.

2. Në Programi Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndryshohet afati i miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, (ZKM) – 30.11.2018.

3. Ngarkohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 04/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 05/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Gjilanit për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronave të Kombinatit Bujqësor Industrial –Gjilan në pronësi të komunës, të cilat aktualisht janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Gjilanit, respektivisht për sigurimin e lokacionit për "VARREZAT E QYTETIT".

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Zona Kadastrale Velikincë me numra të parcelave: P-70403006-00001-1, sipërfaqja 46280 m$^2$; P-70403006-00001-14, sipërfaqja 5330 m$^2$; P-70403006-00004-0, sipërfaqja 48195 m$^2$ dhe Zona Kadastrale Gjilan me numër të parcelës P-70403013-01376-15 me sipërfaqe 4045 m$^2$.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet përqind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar për hapjen e lokacionit për "Varrezat e Qytetit".

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 06/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Ferizajt për tërheqjen nga procesi i privatizimit të pronave të ish Korporatës Bujqësore në pronësi të komunës, të cilat aktualisht janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Ferizajt, respektivisht për sigurimin e lokacionit për "Ndërtimin e një ambulance dhe një Shtëpie të Pleqve".

2. Ngastrat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Ngastra me Nr.96-3, me sipërfaqe prej 6043 m$^2$.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet përqind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri ne shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar për "Ndërtimin e një ambulance dhe një shtëpie të pleqve".

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 07/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Suharekës për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronave të Ndërmarrjes Shoqërore IGK "Ballkan" – Suharekë në pronësi të komunës, të cilat aktualisht janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik "Zhvillimit Ekonomik të Komunës".

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Zona Kadastrale Shirokë, Suharekë me numra të parcelave: 2307-2, sipërfaqja 210284 $m^2$; 2313-0, sipërfaqja 65546 $m^2$; 2314-0, sipërfaqja 5957 $m^2$; 2315-1 me sipërfaqe 23524 dhe 2775-1 me sipërfaqe 4480 $m^2$.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet përqind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar për realizimin e interesit publik në Komunën e Suharekë.

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 08/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Skenderajt për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronave pasuri shoqërore e OBT Produkt-Skenderaj, të cilat aktualisht janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Skenderajt, respektivisht për "PARKUN E BIZNESIT".

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Zona Kadastrale POLAC i Ri me numra të parcelave: P-72015050-00424-0 me sipërfaqe 9235 m², P-72015050-00425-0, sipërfaqja 956 m², P-72015050-00423-0 , sipërfaqja 6982 m² dhe P-72015050-00422-0 me sipërfaqe 332919 m².

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet përqind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar për hapjen e lokacionit për "PARKUN E BIZNESIT".

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 09/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Deçanit për tërheqjen nga procesi i privatizimit me qëllim realizimit të interesit publik në Komunën e Deçanit, respektivisht për ndërtimin e kompleksit memorial për të gjithë dëshmorët e komunës së Deçanit.

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: ngastra me Nr. 1017-0, me sipërfaqe prej 01.0157 ha ; ngastra me Nr. 1016-1, me sipërfaqe prej 0.48.04 ha; ngastra me Nr. 62-0, me sipërfaqe prej 10.47.20 ha; ngastra me Nr. 71, 72-0, 73-0, me sipërfaqe prej 05.38.35 ha; ngastra me Nr. 538, me sipërfaqe prej 1.57.76 ha.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet përqind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç për ndërtimin e kompleksit memorial për të gjithë dëshmorët e komunës së Deçanit.

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 10/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Junikut për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronave të Kooperativës Bujqësore – Junik në pronësi të komunës, me qëllim të realizimit të interesit publik në Komunën e Junikut, respektivisht për qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: P-73105038-1949-0, P-73105038-1954-0, P-73105038-1955-0, P-73105038-1956-0, P-73105038-1957-0, P-73105038-1958-0, P-73105038-1959-0, P-73105038-1961-0, P-73105038-3298/1, P-73105038-490-0 me sipërfaqe 16.6273 ha.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet përqind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2 e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar për qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Nr. 11/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar Vendimit të Qeverisë Nr. 06/134, të datës 01.03.2017, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me kërkesën e Komunës së Hanit të Elezit, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës e cila gjendet në Zonën Kadastrale, Hani i Elezit, të evidentuar në certifikatën e pronësisë nr. 000.16-0, 00017-1 dhe 00020-0.

2. Prona nga pika 1. e vendimit ipet në shfrytëzim me qëllim të realizimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Rregullues Urban.

3. Prona e dhënë në shfrytëzim, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç asaj të paraparë me Planin Zhvillimor Komunal dhe Planit Rregullues Urban.

4. Obligohet Agjencia Kadastrale e Kosovës që të bëjë regjistrimin e pronës sipas pikës 1. të këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 12/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare "Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale, Faza (dalëse) VI".

2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 13/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për negocimin e Marrëveshjes për "Përkrahje të Programit për Mundësitë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës përfaqësuar nga Organizata Qeveritare për Zhvillim USAID në Republikën e Kosovës.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 14/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/158 të datës 29.11.2013**

1. Pika 4 e Vendimit Nr. 15/158, datë 29.11.2013 ndryshohet, duke e hequr termin 'biometrik'.

2. Pjesët e tjera të Vendimit nr. 15/158 të datës 29.11.2013, si dhe Vendimi nr. 08/167 i datës 22.01.2014 mbeten në fuqi.

3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 15/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, me nr. prot. 3185-18, datë 18.06.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M  P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi dhe krijohet e drejta e servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projekteve:

   - Ndërtimi i linjës ajrore 110kV Therandë - Nën Stacioni Rahovec, zonat kadastrale: Rahovec, Hoqë e Madhe, Zoqishtë, Opterushë dhe Brestovc, Komuna e Rahovecit dhe zonat kadastrale Suharekë, Reshtan, Studentqan, Samadrexhë të Komunës së Suharekës;
   - Ndërtimi i linjës ajrore 220kV për kyçjen e Nën Stacionit Drenas, zonat kadastrale Drenas, Krajkovë, Shtrubullovë, Komuna e Drenasit;
   - Ndërtimi i linjës kabllore 110kV - Nën Stacionit Prishtina 6 - Nën Stacionit Prishtina 4, zona kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës;
   - Ndërtimi i linjës kabllore 110kV për kyçjen e Nën Stacionit Mitrovica, zona kadastrale Mitrovicë, Komuna e Mitrovicës;
   - Ndërtimi i linjës ajrore dhe kabllore 110kV për kyçjen e Nën Stacionit Fushë Kosovë, zona kadastrale Fushë Kosovë, Komuna e Fushë Kosovës dhe zona kadastrale Uglarë, Komuna e Graçanicës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 2054/18, datë 16.04.2018.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.

5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Ndërmarrja Publike Qendrore "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Sh.A" (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.

8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 16/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme (ish shoqërore) të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Renovimi dhe Ndërtimi i objekteve për nevoja të Selisë Qendrore të Federatës së Futbollit të Kosovës" (FFK), Zona kadastrale Prishtinë, komuna Prishtinë, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 ''Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin''.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) dhe Ministria e Financave.

4. Kompensimi i pronave, shpenzimet e procedurës të shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga Federata e Futbollit të Kosovës (FFK).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 17/55**
**Datë: 06.07.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani i Veprimit për zbatimin e Direktivës 2006/123/KE për Shërbimet në Tregun e Brendshëm sipas Ligjit Nr. 05/L-130 për Shërbime.

2. Obligohen ministritë dhe organet tjera përgjegjëse, të përcaktuara si bartëse të masave dhe aktiviteteve të caktuara në Planin e Veprimit, që në afatet e parapara të zbatojnë masat dhe aktivitetet nga përgjegjësia e tyre.

3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë t'i dorëzojë raport Qeverisë së Kosovës për zbatimin e Planit të Veprimit dhe projekt akteve të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për periudhën vijuese raportuese, çdo 12 muaj nga nxjerrja e këtij Vendimi.

4. Obligohen ministritë dhe organet tjera përgjegjëse, të përcaktuara si bartëse të masave dhe aktiviteteve të caktuara në Planin e Veprimit, që një herë në vit të dorëzojnë raport Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për masat dhe aktivitetet e ndërmarra për periudhën e kaluar raportuese si dhe të projekt akteve të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për periudhën vijuese raportuese.

5. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të njoftojë për këtë Plan të Veprimit ministritë dhe organet tjera përgjegjëse të përcaktuara si bartëse të masave dhe aktiviteteve të caktuara në Planin e Veprimit.

6. Plani i Veprimit është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

7. Vendimi të zbatohet në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë dhe Udhëzuesit dhe Manualit për Hartimin e Koncept dokumenteve.

8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPOZIMIN E DIREKTIVËS SË SHËRBIMEVE NË TREGUN E BRENDSHËM (2006/123/EC) PËR PERIUDHËN 2017 – 2022

**ANEKSI I** – Korniza (e përgjithshme) horizontale legjislative dhe institucionale për implementimin e Direktivës së Shërbimeve në Tregun e Brendshëm

| AKTIVITETI | INSTITUCIONI KOMPETENT (Qeveria, Ministritë, autoritetet tjera kompetente) | AKTIVITETI I PLANIFIKUAR | | PERIUDHA E REALIZIMIT | |
|---|---|---|---|---|---|
| **1. Intervenimet legjislative horizontale** | Qeveria | Ndryshimet e:<br>1.1 Rregullores nr. 9/2011 e Punës së Qeverisë;<br>1.2 Udhëzimit Administrativ 3/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative;<br>1.3 Rregullores nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar; | Përputhja e plotë me Direktivën e shërbimeve në tregun e brendshëm 32006L0123 [P] dhe zbatimi i nenit 22 të Ligjit Nr. 05/L-130 për Shërbimet | Miratimi i ndryshimeve të rregulloreve<br>TM III 2018 | Hyrja në fuqi<br>TM IV 2018 |
| **2. Zbatimi i Ligjit Nr. 05/L-130 për Shërbimet** | Ministria e Tregtisë dhe Industris (MTI), ministritë e linjës dhe autoritetet e tjera kompetente | 2.1 Njoftimi i draft akteve sektoriale dhe dhënia e opinioneve nga Departamenti Ligjor i MTI-së sipas Nenit 22 të Ligjit Nr. 05/L-130 për Shërbimet dhe Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Njoftimit dhe Vlerësimit të Përputhjes së Draft Akteve Normative me Ligjin për Shërbimet | | TM IV 2017 – Vazhdon<br>(IPA 2016) | |
| | Qeveria | 2.2 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Njoftimit dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë së Draft Akteve Normative me Ligjin për Shërbimet | | TM I 2018 | TM II 2018 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3. Krijimi i Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK)** | MTI, ministritë e linjës dhe autoritetet tjera[1] | 3.1 Krijimi i pjesës informative të Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK) për shërbimet sipas Rregullores për Krijimin dhe Funksionimin e PVK-së (nëse është e zbatueshme, si plotësim i regjistrave elektronik ekzistues të licencave) | TM IV 2018 – TM IV 2020<br>(IPA 2017) | |
| | MTI dhe Ministria e Administratës Publike | 3.2 Krijimi i pjesës së procedurave elektronike të PVK-së, sipas Rregullores për Krijimin dhe Funksionimin e PVK-së | TM IV 2018 – TM IV 2022<br>(IPA 2017) | |
| | Qeveria | 3.3 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për Pikën e Vetme të Kontaktit për Shërbime | TM III 2018 | TM IV 2018 |
| **4. Fuqizimi i kapaciteteve administrative** | Qeveria | 4.1. Krijimi (në nivel shtetëror) i një Rrjeti të Personave Kontaktues për implementimin e Direktivës së Shërbimeve të BE-së përmes Vendimit të Qeverisë (d.m.th. emërimi zyrtar i "Zyrtarëve të Emëruar për Shqyrtim" të cilët e kanë realizuar shqyrtimin sipas IPA 2014, Projektit të Financuar nga BE) | TM II 2018 | |
| | MTI, ministritë e linjës dhe autoritetet tjera[2] | 4.2. Monitorimi i implementimit të Planit të Veprimit (PV) në pjesën e ndryshimeve vjetore të legjislacionit sektorial dhe implementimit të tyre; | Vazhdon (IPA 2016) | |
| | Ministritë e linjës dhe organet tjera | 4.3. Raportimi vjetor te MTI lidhur me masat dhe aktivitetet e zbatuara për periudhën paraprake të raportimit dhe parashikimet për masat dhe aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme të raportimit. | | |
| | MTI | 4.4. Përgatitja e Raportit për implementimin e PV-së, një herë në vit për periudhën paraprake, deri në ditën e anëtarësimit | | |
| | MTI dhe ministritë e linjës dhe organet tjera të nivelit qendror dhe lokal | 4.5 Trajnimet, Seminaret, Punëtoritë | | |

[1] Përfshirë por pa u kufizuar në: MKRS; MAPH; MTI; MeI; MASHT; MBPZHR; MZHE; MF; MPB; MSH; MD; Banka Qendrore; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Agjencia Kadastrale; Oda e Avokatëve; Oda e Ndërmjetësve; Interpretët Gjyqësor; ShKÇAK etj.

[2] ibid;

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | MTI | 4.6 Propozimi për ndryshimet e Rregullores për sistematizimin e MTI (2015) në pajtim me aktivitetet nr. 4.7. dhe 4.8. më poshtë; | Data e miratimit të rregulloreve<br>TM III 2018 | Hyrja në fuqi<br>TM IV 2018 |
| | MTI | 4.7. Angazhimi i 4 punonjësve në MTI (Departamenti Ligjor) për të punuar në implementimin e nenit 22 të Ligjit për Shërbime (Divizioni për vlerësimin e përputhjes së draft akteve të njoftuara);<br>4.8. Emërimi i dy punonjësve në MTI (Departamenti i Tregtisë/Turizmit) për të punuar në krijimin e PVK-së dhe në emër të saj për ta koordinuar implementimin e aktiviteteve nr. 3.1. dhe 3.2. si më lart; | TM IV 2018 (IPA 2017) | |
| **5. Rritja e Vetëdijesimit** | MTI | 5.1. Implementimi i masave dhe aktiviteteve individuale që përcaktohen në Strategjinë e Komunikimit dhe Dukshmërisë dhe Planin e Veprimit për Implementimin e saj, sikurse është përgatitur sipas IPA 2014, Projekt i Financuar nga BE; | Vazhdon (IPA 2016) | |
| | | 5.2. Rishikimi i Strategjisë së Komunikimit dhe Dukshmërisë dhe i Planit të Veprimit për Implementimin e saj sipas nevojave të identifikuara për promovimin e mëtejmë të përfitimeve nga implementimi i Direktivës së Shërbimeve të BE-së; | TM IV 2019 | |

**ANEKSI II** – **Korniza legjislative vertikale (sektoriale) për implementimin e Direktivës së Shërbimeve në Tregun e Brendshëm**

| AKTIVITETI/ SHËRBIMI | MINISTRIA KOMPETENTE (ose autoriteti tjetër kompetent) | LIGJI (DHE AKTI NËNLIGJOR) QË E PËRCAKTON KUFIZIMIN (në legjislacionin shtetëror) | NENI QË E PËRCAKTON KUFIZIMIN (në legjislacionin shtetëror) | NENI I DIREKTIVËS SË SHËRBIMEVE | AKTIVITETI I PLANIFIKUAR | DATA E MIRATIMIT TË LEGJISLACIONIT SHTETËROR | HYRJA NË FUQI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1. MINISTRIA E DREJTËSISË** | | | | | | | |
| 1.1 Avokat | Oda e Avokatëve të Kosovës<br><br>Ministria e Drejtësisë | • Rregullorja mbi themelimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqërive të Avokatëve, Zyrave të Përbashkëta të Avokatëve dhe bashkëpunimin/lidhjen e zyrave të avokatëve, Shoqërive të Avokatëve dhe Zyrave të Përbashkëta të Avokatëve (29 tetor 11) | Nenet 1 deri 16 | Neni 10 (2) (d – g) e qartë, e kuptueshme, paraprakisht e bërë publike, objektive, e qasshme | **Të përshtatet** Rregullorja nga viti 2011 **ose të Shfuqizohet** (zëvendësohet) me Rregullore të re, pasi që ajo nga viti 2011 bazohet në Ligjin e vjetër për Avokatinë nga viti 2009. [3] | TM IV 2019 | TM IV 2019 |
| 1.2 | Oda e Avokatëve të Kosovës<br><br>Ministria e | • Rregullorja për Licencimin e Avokatëve të Huaj (29 tetor 2011) | Nenet 1 deri 11 | Neni 10 (2) (d – g) e qartë, e kuptueshme, paraprakisht e bërë publike, objektive, e qasshme | **Të përshtatet** Rregullorja nga viti 2011 **ose të Shfuqizohet** (zëvendësohet) me | TM IV 2019 | TM IV 2019 |

